



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

**KOMITETI DREJTUES PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË**

V E N D I M

Nr. 1, datë 12.10.2017

I

**KOMITETIT DREJTUES PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, urdhrit nr. 157, datë 04.10.2017, “Për ngritjen e Komitetit Drejtues për ndjekjen e procesit të ristrukturimit të institucioneve të varësisë”,

V E N D O S I:

1. Ngarkimin e Inspektoratit Qendror të drejtojë, koordinojë dhe të mbikqyrë punën e Inspektorateve Shtetërore, gjatë procesit të ristrukturimit të tyre, si dhe të marrë masa që brenda kompetencave ligjore të urdhërojë kryerjen e inspektimeve, nga inspektorët e Inspektorateve Shtetërore, me dokumente e listë verifikimi standarde, online, të miratuara nga Inspektorati Qendror, bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SENIDA MESI